




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**


*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Dt. 30.05.2025  
Nr. 3-2086/2

Komisioni i MASHTI për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të IPAAP, në bazë të dispozitave të nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në mbështetje të Udhëzimit administrativ nr. 17/2016 - Kriteret për licencimin dhe rilicencimin e institucioneve arsimore private parauniversitare, të mesme të larta profesionale dhe institucioneve aftësuese profesionale si dhe kërkesës së institucionit “German Gymnasium”, lagjja Veternik, rr. “Gjilani” në Prishtinë, me nr. prot.3/1732 dt. 05.05.2025, nxjerr:

**VENDIM**

1. LICENCOHET institucioni aftësues profesional “German Gymnasium”, lagjja Veternik, rr. “Gjilani” në Prishtinë, për ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelet III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK për programet:
  - 1.1. “Teknologji e Informacionit, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”
2. Veprimtaria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ushtrohet në përputhje me certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe legjislacioni në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-**  
**Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija- Ministry of Education, Science,**  
**Technology and Innovation**

---

Prishtinë  
Ref.nr: 3-2086/1

**Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e institucioneve private parauniversitare (IPAP-ve), në bazë të nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-32 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13, 42, 125, 127 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (G. z. nr. 20/21 qershor 2016, Prishtinë), Udhëzimit administrativ nr.17/2016 “Për kushtet dhe kriteret për licencimin e institucioneve private arsimore dhe aftësuese parauniversitare, për nivelet fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë dhe të institucioneve aftësuese profesionale parauniversitare”, Vendimit nr.2-106 të datës 30.01.2024, si dhe Kërkesës së institucionit privat arsimor parauniversitar “German Gymnasium” në Prishtinë, me nr. prot. 2279, më datë 01.08.2024 merr këtë:**

**VENDIM**  
**Për licencim**

1. Licençohet institucioni privat arsimor parauniversitar “German Gymnasium” në Prishtinë, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore për nivelin e arsimit të mesëm të lartë (klasat 10-12), drejtimin shkencë natyrore, në kohëzgjatje prej një cikli arsimorë, duke filluar nga viti shkollor 2025-2026.
2. Licenca e lejuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, për nivelin e mesëm të lartë do të jetë prej 22 nxënës në klasë (3 klasë), gjithësej 66 nxënës.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e institucioneve private parauniversitare (IPAP-ve) (më tutje Komisioni), në takimin e datës 30.05.2025 shqyrtoi Kërkesën dhe gjithë dokumentacionin e bashkangjitur të institucionit privat arsimor parauniversitar: “German Gymnasium” me nr. protokoli 2/279, më datë 01.08.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkangjitur si dhe raportit nga vizita në institucion me datë 16.04.2025, konstatoi se, institucioni privat arsimor parauniversitar, “German

"Gymnasium" në Prishtinë, i plotëson kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë arsimore për nivelin të mesëm të lartë (klasat 10-12) në kohëzgjatje prej një cikle arsimore, prandaj bazuar në kërkesën e parashtruar si dhe dëshmi të tjera, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e përkënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në afat prej 30 ditëve nga data e pranimit të vendimit.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Institucionit privat arsimor parauniversitar "German Gymnasium" në Prishtinë;
2. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI;
4. Divizionit për arsim privat parauniversitar;
5. Inspektoratit të Arsimit në MASHTI;
6. Arkivit të MASHTI.

Saranda Çeku, kryesuese e komisionit

